

Kujtim Kasami, MA¹

UDC:
342.829.2:17(497.7)

**PROCESI ZGJEDHOR DHE SJELLA ETIKE NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË**

**ИЗБОРНИОТ ПРОЦЕС И ЕТИЧКОТО ОДНЕСУВАЊЕ ВО
РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА**

**THE ELECTION PROCESS AND ETHICAL BEHAVIOUR IN
REPUBLIC OF MACEDONIA**

Abstract

In the public of Republic of Macedonia, it became a rule for the elections to be debated solely through the prism of the irregularity during the election process and almost never to open a competent debate on systematic elections on the basis of the Law for their selection and evaluation related to the effects that they have on the two key objectives an election system should achieve, and this is a stable government and a representative parliament. Throughout this period, the involvement of the scientific community is only a reaction to debates between the parties, and not in more serious reflections on the qualified public of experts dealing with the subject. In this understanding, this work is focused debating on the political culture of election process. It is about the possibility of good practice standards of countries with a long democratic tradition to join the electoral process.

Key words: *political culture, elections, electoral process, electoral system, ethical behavior, political parties, election campaign.*

¹ Doktorant në shkencat politike, e-mail: kujtimkasami@gmail.com

Hyrje

Në botën moderne nevoja për rilidhjen e etikës dhe politikës shihet më qartë përmes proceseve të reja politike dhe veprimeve, si dhe aksiologjinë e saj të re që ndodh si një imperativ i nevojshëm i praktikës bashkëkohore njerëzore. Për më tepër, etika e perceptuar si një filozofi morale sot është e mundur në bazë të *etikës* ekzistuese dhe rregullave të saj të jetës së përbashkët, d.m.th. kryesisht përmes jetës politike të kuptuar si një grup marrëdhëniesh qytetarësh ose qytetarë të një qyteti, komune, shteti, dhe vetë politika merr kuptimin dhe rëndësinë e saj.

Në ditët e sotme, në shekullin e njëzet e një, pas shpërbërjes së disa sistemeve ish-autoritare politike në disa prej shteteve të mëdha të botës, në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare, siç është sistemi socialist i ashtuquajtur komunist, është shfaqur një interes i rëndësishëm në kulturën e votuesve dhe për partitë politike. Në veçanti, këtu do të theksojmë Doktrinën e Bushit për Demokratizimin e Botës me çdo kusht, që do të thotë në një farë mënyre me një mjet të ndryshëm ndikimi.² Nëse në hulumtimet krahasuese të zgjedhjeve në vitet '80 dhe në fillim të viteve '90, tema prioritare ishin avantazhet dhe disavantazhet e modeleve zgjedhore, dy dekadat e fundit, veçanërisht me përvojat e vendeve në tranzicion, janë të defokusuara dhe me kujdes janë drejtuar drejt një komponenti tjetër në zgjedhje. Bëhet fjalë për sjelljen etike dhe kontributin e saj në besueshmërinë e procesit zgjedhor.

Veçanërisht e rëndësishme është që kjo çështje të kalojë kornizat e sovranitetit kombëtar, d.m.th., të marrë një verifikim shtesë të karakterit demokratik të zgjedhjeve dhe të institucioneve ndërkombëtare. Është një vlerësim shumë i rëndësishëm që ka pasoja në aspiratën për integrimin euroatlantik të këtyre vendeve. Kur flasim për këtë aspekt të zgjedhjeve në vendin tonë, vlen të përmendet se polemikat e shumta që pasuan zgjedhjet ishin në një masë të madhe reflektim të një konteksti më të gjerë socio-politik sesa mungesës së rregullores zgjedhore.

Në Republikën e Maqedonisë nuk është bërë ndonjë hulumtim i veçantë për ndikimin e përputhjes me standardet e sjelljes etike në procesin zgjedhor, përveç një pjese të punimeve në fushën e shkencave politike, siç janë: Pažanin, 2001³; Vidojeviq, 2010; Veregiq, 2000⁴; dhe

² Dimitar Mirçev dhe Lidija Hristova, *Модерната Политологија*, FON dhe Kultura, 2008, f.198.

³ Ante Pažanin. *Etika i Politika*. Zagreb: Ocean Graf, 2001.

⁴ Dushan Veregiq. *Изборни прогнози*. Shkup: ИСППИ, 2000.

të tjerët. Të gjitha arsyet e mësipërme na inkurajojnë të shqyrtojmë rolin dhe rëndësinë e sjelljes etike në procesin zgjedhor.

➤ **Fjalët kyçe:**

Kultura politike - një grup i të gjitha vlerave materiale dhe shpirtërore që u ngritën si pasojë e ndërhyrjes materiale dhe shpirtërore të njeriut në natyrë, shoqëri, mendim;

Zgjedhje - një proces me të cilin njerëzit e besojnë fuqinë politike të trupit përfaqësues dhe në shumë shtete moderne, demokratike dhe presidentin e republikës, të cilët përfaqësojnë vullnetin e tij sovran;

Proces zgjedhor - një proces në shoqërinë moderne, i cili është një element kyç për legjitimimin e procesit politik, një tregues i tipit, kapacitetit dhe efektivitetit të praktikave demokratike qeverisëse;

Sistemi zgjedhor - një grup marrëdhëniesh, aktivitetesh dhe procedura sociale që lindin gjatë zgjedhjes së organeve përfaqësuese dhe Presidentit të Republikës, të cilat rregullohen me rregullore ligjore;

Sjellje etike - lloji i sjelljes njerëzore që ndjek norma specifike të vlerës për respektimin dhe ndjekjen e së mirës dhe refuzimin dhe shmangien e së keqes. **Sjellje etike:** është ajo sjellje që pranohet nga shoqëria si moralisht dhe ligjërisht e mirë dhe e drejtë;⁵ Një kod etike apo kod sjellje, përcakton vlerat dhe parimet etike, si mënyrën e sjelljes, duke përfshirë edhe sjelljen individuale. Është e rëndësishme që kodi etik, të mbështesë një mjedis të favorshëm për sjelljen, në përputhje me vlerat dhe parimet e shprehura në normat dhe standardet etike;

Partitë politike - format e shoqatave të organizuara të qytetarëve dhe grupeve për të shprehur interesat e tyre të përbashkëta dhe referimin e tyre në qendra vendimmarrjeje politike. Termi parti politike është mjaft i konsumuar si në literaturë shkencore ashtu edhe në jetën e përditshme. Kjo është e logjikshme në qoftë se nisemi nga fakti se partitë politike në ditët e sotme janë bartëse dhe organizatore kryesore të jetës politike pothuajse në çdo vend të botës. Një definicion i njohur i partive politike vjen nga shkencëtari i shkencave politike Antony Downs, i cili shkruan: “Një parti politike është një ekip i njerëzve që kërkon të kontrollojë aparataturat qeverisëse duke fituar zyrën gjatë një palë zgjedhjeve të rregullta”⁶;

Fushatë zgjedhore - një periudhë e përcaktuar saktësisht përpara mbajtjes së zgjedhjeve, e cila është e pajisur me norma ligjore të

⁵https://www.google.com/search?source=hp&ei=2avMW5qjNIKVsAHvirPYCw&q=sjellja+etike&oq=sjellja+etike&gs_l (15.10.2018).

⁶ Ferat Polisi dhe Ali Musliu. *Sociologjia e së drejtës*, Shkup, Vatra, 2015, f.174.

përshtatshme, në të cilat partitë, organizatat, lëvizjet ose koalicionet e regjistruara politike, si dhe kandidatët e pavarur, përmes propagandës për fitimin e votave dhe të fitojë fuqi.

1. Lënda e hulumtimit

Subjekti i hulumtimit në tezën e këtij punimi do të jetë: Sa parimet etike të Kodeksit për Zgjedhje të Lira dhe Demokratike aplikohen gjatë zgjedhjeve. Parimet etike janë një konstruksion shumëdimensional. Supozohet se aplikimi më i gjerë i çdo dimensionit veç e veç dhe në mënyrë të pavarur nga subjektet politike është në lidhje të konsiderueshme me procesin zgjedhor, domethënë realizimin e zgjedhjeve të suksesshme. Në të njëjtën kohë, supozohet se kjo marrëdhënie ndërmjet variablave të ekzaminuar arrihet kur suksesi i zgjedhjeve matet si nëpërmjet treguesve objektivë dhe nëpërmjet perceptimit subjektiv të treguesve të performancës së zgjedhjeve. Eksplorimi për respektimin e të gjitha ligjeve, rregullat dhe rregulloret e zgjedhjeve në R. Maqedonisë, të cilat kontribuojnë në organizimin e zgjedhjeve të suksesshme. Gjithashtu tema e këtij punimi është vëzhgimi i sundimit të ligjit në organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve për të kontribuar në zgjedhje të suksesshme. Në këtë punim do të përpunohet në veçanti raporti i realizimit të suksesshëm të zgjedhjeve dhe respektimi i integritetit të të punësuarve në administratën publike dhe shtetërore, si dhe institucionet dhe organizatat e tjera të financuara nga buxheti i shtetit, buxhetet e pushteteve lokale dhe rajonale, si dhe kompanive me kapital shtetëror siç janë: 1) presioni apo përpjekje për të bërë presion punonjësve të administratës publike dhe shtetërore nga kandidatët ose përfaqësuesve të partive politike në zgjedhje, 2) presioni apo përpjekje për të bërë presion mbi personelin në institucionet apo institucione të financuara nga buxheti i shtetit, buxhetet lokale dhe rajonale nga kandidatët ose nga përfaqësues të partive politike në zgjedhje, 3) presion apo përpjekje për presion për të punësuarit në kompanitë me kapital shtetëror nga ana e kandidatëve ose përfaqësuesve të partive politike në zgjedhje.

Qëllimi i procesit zgjedhor është të fitojë funksione publike dhe të marrë pushtetin dhe ndikimin në politikën publike dhe burimet shtetërore. Zgjedhjet janë rezultat i një procesi kompleks që kërkon pjesëmarrjen e shumë faktorëve, secili me rolet dhe agjendat e ndryshme. Fituesit dhe humbësit dalin nga zgjedhjet. Gjithkush dëshiron të jetë fitues, askush nuk dëshiron humbje. Rreziqet mund të jenë mjaft të larta

për të qenë tundime për të siguruar një fitore të caktuar nëpërmjet mjeteve joetike dhe të paligjshme. Integriteti është një pjesë integrale e parimeve të demokracisë dhe është pjesë përbërëse e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Zgjedhjet e lira, të drejta dhe konkurruese janë bazë për një formë të përfaqësimit të qeverisë. Pa integritet, nuk ka garanci se vullneti i votuesve do të pasqyrohet në rezultatet e zgjedhjeve.⁷ Zgjedhjet mund të përgatiten paraprakisht, duke kryesuar mbi fituesit dhe humbësit. Rregullat e zgjedhjeve mund të shkelen duke minuar votuesit me pjesëmarrjen e kandidatëve, duke hedhur dyshime mbi legjitimitetin e rezultateve. Zgjedhjet pa integritet tejkalojnë qëllimin e zgjedhjeve demokratike dhe nuk mund të konsiderohen të lira dhe të drejta, dhe ky punim shqyrton gjithashtu lidhjen midis zgjedhjeve të suksesshme dhe integritetit të çdo qytetari që nuk i nënshtrohet ndonjë kërcënimi për punësimin dhe sigurimin shoqëror si rezultat i mbëshetjes ose mosmbëshetjes së tyre me ndonjë parti politike ose kandidat. Zbatimi i standardeve etike dhe i parimeve të Kodit të Etikës për zgjedhje të drejta dhe të lira është i një rëndësie të veçantë⁸, sepse pa ligjet, rregullat, rregulloret, parimet dhe standardet më të mira nuk mund të jetë asgjë më shumë se një qëllim i mirë dhe prandaj dëshiroj që shkencërisht dhe praktikisht të provojë se a ekziston lidhje mes aplikimit të standardeve etike në procesin zgjedhor me **zgjedhjet e suksesshme**, që nënkupton një proces zgjedhor i pranueshëm për të gjithë kandidatët dhe partitë politike, ku respektohen rregullat e përgjithshme dhe ligjet për zgjedhjet, pa presione nga punonjës dhe anëtar të ndonjë partie politike apo kandidat i ndonjë partie politike.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të kontrollojë nëse, si dhe në ç'mënyrë zbatohen standardet për sjellje etike në procesin zgjedhor.

2. Morali politik dhe politikat globale

Morali politik në disa qarqe është i kontestueshëm për arsye se një numër i madh njerëzish konsideron se politika dhe morali nuk shkojnë së bashku, sepse fjala politikë para së gjithash të kujton aftësinë e manipulimit me njerëzit, konsiderojmë se politika, ekonomia, morali dhe vlerat e tjera mund dhe patjetër duhet të bashkëveprojnë.⁹ Ndoshta

⁷ <https://www.scu.edu/ethics/focus-areas/government-ethics/resources/ethical-issues-for-political-candidates/>

⁸ Dean Geuras and Charles Garofolo. *Practical Ethics in Public Administration*, Vienna, Virginia: Management Concepts, 2005, f.225.

⁹ Nexhat Ibrahim. *Bazat e etikës islame-Ahlaku*, Shkup: Logos-A, 2005, f.183.

më e drejtë është të flitet për politikën morale, domethënë për politikën dhe moralin. Morali dhe politika janë të orientuar nga vlerat, në të dyja kategoritë pjesëmarrës janë njerëzit, përgjegjësia politike domosdo nënkupton edhe përgjegjësi morale, edhe morali edhe politika janë të orientuar nga e mira për të gjithë. Të gjithë vendet po përjetojnë një proces kompleks zhvillimesh politike globale ku janë përfshirë institucionet ndërkombëtare, korporatat shumëkombëshe, grupet qytetare, pra shkurt politika globale. Shtetet fillojnë ta humbin sovranitetin e tyre jo vetëm nga numri i madh i organizatave joqeveritare por në radhë të parë nga ndërmarrjet korporative gjigante, që bëhen gjithnjë e më të fuqishme, fuqi kjo e cila haptazi i rrënon të gjitha kufijtë paraprakë. Sa më shumë që shtetet t'u hapin rrugët ndërmarrjeve me veprim global dhe rrymave financiare, zvogëlohet mundësia e ndikimit dhe dobësojnë instrumentet tradicionale të ekonomisë dhe politikës financiare siç janë tatimet dhe kamatat. Liberalizimi i jashtëm, shuarja e rregullit të brendshëm shtetëror dhe mekanizmat e tregut global e prekin sovranitetin e shtetit. Shumë detyra të cilat i kishte kryer vetë çdo qeveri deri më tani, tani e tutje duhet të kryhen në bashkëpunim me qeveritë tjera.¹⁰ Nëse problemet marrin gjithnjë e më shumë karakter global, atëherë duhet të "globalizohet" edhe zgjidhja politike e problemit. Për këtë ekzistojnë koncepte të ndryshme deri në ngritjen e një shteti ndërkombëtar. Ndërmjet shteteve janë krijuar edhe shkëmbime të rregullta të informacionit shkencor. Midis tyre janë arritur marrëveshje, në të cilat grupe shtetesh marrin përsipër angazhime të tilla si një premtim për të mos testuar armë bërthamore mbi tokë. Po ashtu janë hartuar traktate për të mbrojtur kafshët e egra që migrojnë përtej kufijve shtetërorë. Luftërat kundër-shtohen dhe u jepet zgjidhje. Secila nga këto ngjarje tregon për një zgjedhje kolektive të një grupi prej dy apo më shumë shtetesh dhe kështu këto bëhen shembuj të politikës - përdorimi i pushtetit për të bërë zgjedhje kolektive - ndërmjet shteteve, për një grup shtetesh, më tepër se sa brenda një shteti. Kjo quhet zakonisht politika ndërkombëtare apo politika globale. Këto dy terma nënkuptojnë afërsisht të njëjtën gjë, përveç se "politika globale" do të thotë që në politikë përfshihen diçka më tepër sesa vetëm shtetet. Aktorët kryesor të saj janë shtetet, por në të janë të përfshira edhe lëvizjet sociale ndërkombëtare, korporatat shumëkombëshe dhe aktorë të tjerë jo qeveritarë. Thuajse çdo ditë dëgjojmë dhe lexojmë për aleanca, bashkëveprime dhe koordinime midis shteteve apo

¹⁰ W. Phillips Shiveley. *Hyrje në shkencat politike*, Tiranë, 2010, f. 237.

përfaqësive të tyre me qëllim të menaxhimit apo zgjidhjeve të problemeve të ndryshme. E gjithë kjo ndodh fal lëvizjeve të lira të njerëzve dhe mallrave, dhe zhvillimit të madh tekniko-teknologjik.

3 . Rëndësia e hulumtimit

Çdo punë shkencore pak a shumë pritet të ketë rëndësi teorike, rëndësi shkencore, metodologjike dhe aplikative-politike. Në fakt, këto lloje kuptimesh janë të lidhura ngushtë.¹¹ Tërheqja e kufirit ndërmjet punës dhe veprës shkencore e specialistike nuk është çdoherë e lehtë; për këtë arsye shpesh është i domosdoshëm shqyrtimi dhe hulumtimi i kujdesshëm. Që më përparësisht të përcaktohet se ç’janë në realitet, puna dhe vepra shkencore-kërkimore dhe cilat janë cilësitë e tyre themelore, medoemos paraprakisht duhet thënë së paku disa fjalë për atë se ç’janë shkenca dhe kërkimi (hulumtimi). Me termin *shkencë* rëndom nënkuptojmë mësimin e rregulluar, të sistematizuar e të verifikuar për diçka, të arritur me hulumtim dhe shqyrtim metodik, të kujdesshëm e të ndërgjegjshëm. Ndonëse me termin *kërkim (hulumtim)* nënkuptojmë gjurmimin sistematik të fakteve nga të cilat mund të nxirren parimet dhe ligjshmëritë e caktuara shkencore. Në pajtim me këtë, shkencën, në të vërtetë, e përbëjnë rezultatet, ligjet deri te të cilat vihet me anë të kërkimeve.¹²

Rezultatet e këtij studimi mund të jenë një bazë e mirë për kërkime të mëtejshme në fushën e shkencave politike dhe gjithashtu mund të kontribuojnë në cilësinë e procesit zgjedhor, pra për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e zgjedhjeve.

Pritet që rezultatet që dalin nga ky studim do të motivojnë politikanët të kenë më shumë përgjegjësi dhe seriozitet në standardet e monitorimit të sjelljes etike dhe për të inkurajuar ata gjatë procesit zgjedhor të mënyrë të vazhdueshme për të monitoruar, verifikuar dhe vlerësuar sjelljen etike.

4. Interpretim i rezultateve

Hulumtimi empirik, i realizuar në një mostër prej 1125 të anketuar në Republikën e Maqedonisë, kishte për qëllim të shqyrtonte lidhjen ndërmjet zbatimit të standardeve etike, normave dhe vlerave në

¹¹ Brajman Alen. *Методи на опитественоото истражување*, Përkthim: Ruzhica Sacanoska, Universiteti „Св. Климент Охридски“ - Битола, 2015, f.55.

¹² Mid’had Shamiq. *Si shkruhet vepra shkencore*, Shkup: Logos-A, 2009, f.22.

procesin zgjedhor, dhe, nga ana tjetër, zgjedhjeve të suksesshme në Republikën e Maqedonisë.

Në bazë të hulumtimit të realizuar në periudhën janar-mars të vitit 2018, sipas të anketuarve mund të konkludojmë se ekziston një lidhje e ngushtë midis respektimit të standardeve etike, vlerave dhe normave morale dhe zgjedhjeve të suksesshme, qofshin ato lokale po ashtu edhe në zgjedhjet parlamentare. Po ashtu në masë jo të duhur respektohen standardet dhe normat etike në zgjedhje dhe kjo është si pasojë e mos promovimit të duhur të Kodeksit për zgjedhje të lira dhe demokratike në kampanjat zgjedhore nga ana e liderëve politik, kandidatëve dhe komisionarëve zgjedhor. Në legjislacionin e R.M. nuk është i rregulluar dhe i parashikuar një “trup” i cili do të shërbente si mekanizëm për të rregulluar dhe mbrojtur respektimin e standardeve dhe principeve etike në procesin zgjedhor nga ana e të gjithë palëve dhe faktorëve pjesëmarrës në zgjedhje.

Tabela nr.1 - Gjinia

Variabla	Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	598	53,2	53,2	53,2
	527	46,8	46,8	100,0
	1125	100,0	100,0	

Nga tabela nr.1 shihet qartë se përafërsisht gjysma (598) e të anketuarve në mostër i përkasin gjinisë mashkullore, përkatësisht 53.2% të totalit dhe 527 ose 46.8% të gjinisë femërore.

Tabela nr. 2 - Nacionaliteti

Variabla	Frekuenca	Përqindje	Përqindje valide	Përqindje kumulative
Valid	M	422	37,5	37,5
	S	588	52,3	89,8
	T	48	4,3	94,0
	R	12	1,1	95,1
	V	10	1,9	96,0
	S	18	1,6	97,6
	T	27	2,4	100,0
	T	1125	100,0	100,0

Siç shihet nga tabela nr.2, pjesëmarrja më e madhe me përkatësinë kombëtare në këtë studim shkencor janë: shqiptarët (588) me 52.3% dhe maqedonasit (422) me 37.5%), ndërsa pjesëmarrje më të vogël kanë turqit (48) me 4.3%, serbët me 1.6%, romët (12) me 1.1%, vllahët (10) me 0.9 dhe të tjerët (27) me 2.4%.

5. Vërtetimi i hipotezës kryesore

Hulumtim empirik, i kryer në një mostër prej 1,125 të anketuarve në Maqedoni, me qëllim për të shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet standardeve etike, normave dhe vlerave etike në procesin zgjedhor, dhe, në anën tjetër, zgjedhjeve të suksesshme dhe me integritet në Republikën e Maqedonisë. Hipoteza e përgjithshme është testuar përmes formulimit të hipotezave të veçanta, supozimet e të cilave pranohen si të sakta ose të hedhen si të pasakta. Sipas testeve të kryera, analizave dhe interpretimeve që janë bërë për hipotezat e veçanta, për të identifikuar vlerat e etikës, u treguan lidhje të rëndësishme në procesin zgjedhor për të pasur zgjedhje të suksesshme. Nga përpunimi i përgjigjeve nga intervistat e kryera me ekspertë, erdha në përfundimin se: sjellja etike kontribuon për të legjitimuar zgjedhjet, për rezultate të pranueshme për të gjitha palët, gjegjësisht subjektet politike. Sjellja etike fillon nga fjalimi i udhëheqjes dhe reflektohet te masat. “Po, jam dakord. Por instrumentet që çojnë për respektimin e vlerave morale së pari duhet t’i shohim: në demokratizimin e brendshëm të partive, politika e zgjedhjes së personelit apo kuadrove në institucionet shtetërore duhet të bazohet në bazë të meritokracisë, me media të pavarura, pjesëmarrja aktive e OJQ-ve, opinioni publik më aktivë, në mënyrë që të kontribuojë në fuqizimin më të madh të shoqërisë në përgjithësi”, -një citim nga ekspertët. “Unë pajtohem dhe unë sinqerisht shpresoj se ne do të arrijmë në një fazë të tillë të lirisë së zgjedhjes, kur zgjedhësi/votuesi i zakonshëm të përjetojnë të mirën e votës/zërit të tij, sepse me të që përfaqësohet në parlament apo qeveri, në të vërtetë do të mbroj të drejtat dhe nevojat e tij (votuesit).” - shprehet një tjetër ekspert i intervistuar. Të gjitha përgjigjet në këtë pyetje përfundojnë se “sjellja etike ose respektimi rigoroz i vlerave morale nga ana e pjesëmarrësve (votuesit dhe kandidatët) do të kontribuojë ndjeshëm në procesin zgjedhor të suksesshëm, legjitim dhe të pranueshëm dhe do të ndikojë për të nxitur votuesit për të votuar dhe për të përmirësuar rezultatin zgjedhor”, që nënkupton rezultat zgjedhor të pranuar nga gjithë subjektet politike.

Më saktësisht, sipas provës së hipotezave të veçanta, vërtetohet se:

- Hipoteza e veçantë nr. 1 është konfirmuar - nga gjitha aspektet e hulumtimit vërtetohet se respektimi i ligjeve përkatëse për zgjedhjet gjatë procesit zgjedhor dhe pranimi i përgjithshëm i rregullave dhe rregulloreve të zgjedhjeve do të sigurojë barazinë për të gjithë konkurrentët, është në korrelacion statistikiisht të rëndësishëm me realizimin e zgjedhjeve të suksesshme. Sipas përgjigjeve të të anketuarve, vërehet se, sa më shumë që respektohen ligjet përkatëse për zgjedhjet në procesin zgjedhor në vend, aq më tepër respektohen rregullat etike, normat dhe vlerat etike në zgjedhjet e fundit parlamentare, ($r = .517^{**}$, $p = .000$). Koeficienti i korrelacionit tregon një mesatare të fortë dhe marrëdhënie statistikiisht të rëndësishme pozitive në mes të këtyre dy variablave.

- Hipoteza e veçantë nr. 2 është konfirmuar - të gjitha aspektet e hulumtimit për respektimin e sundimit të ligjit në organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, respektimi i Kodit të sjelljes për zgjedhje të lira dhe të ndershme, i cili bën thirrje për respektimin e ligjeve, rregullave, rregulloreve dhe praktikave më të mira në lidhje me zgjedhjet, është në korrelacion statistikiisht të rëndësishëm me zgjedhjet e suksesshme. Rezultatet e koeficient të Pirsonit tregojnë një korrelacion statistikiisht të rëndësishëm të variablit të pavarur që ka të bëjë me shkallën e respektimit të sundimit të së drejtës në organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në procesin zgjedhor në vend (p.20) me gjithë VV (variablat e varura). Sipas përgjigjeve të të anketuarve, sa më tepër të respektohet sundimi i së drejtës në organizimin dhe kryerjen e zgjedhjeve në vend, aq më shumë respektohen rregullat etike, normat dhe vlerat në zgjedhjet e fundit parlamentare ($r = .461^{**}$, $p = .000$). Koeficienti i korrelacionit tregon një mesatare të mesme kah e forta, që nënkupton marrëdhënie statistikiisht të rëndësishme pozitive në mes të këtyre dy variablave.

- Hipoteza e veçantë nr. 3 është konfirmuar - të gjitha variablat e hulumtimit tregojnë se duke respektuar integritetin e të punësuarve në administratën publike dhe shtetërore, si dhe institucionet dhe organizatat e tjera të financuara nga buxheti i shtetit, siç janë dimensionet: presion apo përpjekje për të bërë presion ndaj punonjësve të administratës publike dhe shtetërore nga kandidatët ose përfaqësuesit e partive politike në zgjedhje, presion ose tentim për presion mbi të punësuarit

në institucionet dhe organizatat e financuara nga buxheti i shtetit, buxhetet e institucioneve lokale dhe rajonale nga përfaqësues të partive politike ose kandidatë në zgjedhje, është korrelacion statistikisht i rëndësishëm me zgjedhjet e suksesshme. Sipas përgjigjeve të të anketuarve, sa më shumë respektohen rregullat etike, normat dhe vlerat në organizimin dhe realizimin e zgjedhjeve të fundit parlamentare në Republikën e Maqedonisë, aq më pak do të jetë presioni apo përpjekja për të ushtruar presion mbi punonjësit e administratës publike dhe shtetërore nga kandidatët apo përfaqësuesit e partitë politike në zgjedhje ($r = -.162^{**}$, $p = .000$). Koeficienti i korrelacionit tregon një lidhje të dobët, por statistikisht të rëndësishme, negative midis dy variablave.

Njohuritë specifike, që rrjedhin nga gjetjet e konfirmuara në mënyrë empirike, sugjerojnë pranimin e hipotezës së përgjithshme. Për rrjedhojë, konstatohet se hipoteza e përgjithshme, e përcaktuar si: Respektimi i vazhdueshëm i parimeve etike të Kodit për zgjedhje për sjellje të ndershme dhe demokratike nga subjektet politike do të kontribuojë ndjeshëm dhe thellësisht për zgjedhje të suksesshme.

Conclusion

Elections are a universal and legal form through which the power is changed and won. However, apart from the technical-formal-legal side, elections must also meet the so-called “spiritual” element, or fulfill the ethical part that is inevitable in the global world where local, regional, and national competition has only been strengthened.

Despite recent amendment of the Law on elections, signing the Code of Ethics is obligatory for free and democratic elections by political parties, it is not sufficient only as a formal act in the presence of the media, but promotion and respect of the ethical principles is needed that are foreseen in the Codex as rules one must abide by.

Political parties must present a copy of the Code of Ethics in their electoral programs for free and democratic elections where every citizen and voter can have access and the appropriate information regarding the Code of Ethics content.

As a society and as a country, all political factors and entities should contribute to having elections of integrity, with results obtained from all competing political forces, and this can be achieved when the ethics will be incorporated in the election process in the Republic of

Macedonia, as part of philosophy with all values, norms and ethical standards.

Recensentë:

Prof. dr. Mersim Maksuti

Prof. dr. Bajram Pollozhani

BIBLIOGRAFIA PUNUESE

Ante Pažanin. *Etika i Politika*. Zagreb: Ocean Graf, 2001.

Brajman Alen. *Методи на општественото истражување*, Pëtkthim:Ruzhica Cacanaska.Universiteti: „Св. Климент Охридски” - Битола, 2015.

Dimitar Mirçev dhe Lidija Hristova, *Модерната Политологија*, FON dhe Kultura, 2008.

Dushan Veregiq. *Изборни прогнози*. Shkup: ИСПИИ, 2000.

Ferat Polisi dhe Ali Musliu. *Sociologjia e së drejtës*.Shkup: Vatra,2015.

Dean Geuras and Charles Garofolo. *Practiical Ethics in Public Administration*. Vienna, Virginia:Management Concepts, 2005.

Mid’had Shamiq. *Si shkruhet vepra shkencore*. Shkup: Logos-A, 2009.

Nexhat Ibrahimimi. *Bazat e etikës islame-Ahlaku*. Shkup: Logos-A, 2005.

W. Phillips Shiveley. *Hyrje në shkencat politike*. Tiranë, 2010.

https://www.google.com/search?source=hp&ei=2avMW5qjNIKVsAHvirPYCw&q=sjellja+etike&oq=sjellja+etike&gs_l
(15.10.2018).

<https://www.scu.edu/ethics/focus-areas/government-ethics/resources/ethical-issues-for-political-candidates/> (20.09.2018).